

VENDIM
Nr. 567, datë 4.10.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 300, DATË 11.5.2022, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË
PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË
PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT ‘SISTEMIM RRUGËSH, BLOKU TE
STADIUMI, POGRADEC’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në tabelën bashkëlidhur vendimit nr. 300, datë 11.5.2022, të Këshillit të Ministrave, numri i pasurisë 1/338, ZK 8581, në numrin rendor 1 të tabelës, zëvendësohet me numrin e pasurisë 1/388.

2. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Bashkia Pogradec.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Bashkia Pogradec, si dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Pogradec, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama